



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA FUSHË-ARRËZ  
KËSHILLI BASHKIAK  
KOMISIONI I EKONOMISË FINANCË BUXHETIT MBIKQYRJES FINANCIARE  
PLANIFIKIMIT TË ZHVILLIMIT STRATEGJIK

Nr. \_\_\_\_\_

prot.

Fushë-Arrëz, më 27.03.2026

PËR : KËSHILLIN E BASHKISË  
FUSHË-ARRËZ

**Relacion i Komisionit të Ekonomisë Finance Buxhetit Mbiqyrjes Financiare Planifikimit të Zhvillimit Strategjik mbi Projektvendimin për miratimin e Tavanëve të Buxhetit Afatmesëm 2027-2029 për Bashkinë Fushë-Arrëz.**

Ne zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, u mbledh sot më, 27.03.2027, Komisioni i Ekonomisë Finance Buxhetit dhe Mbiqyrjes Financiare me anetare : Franc Doda (Kryetar i komisionit), Besjana Marku (Sekretare e Komisionit), Zef Cara (Anetar i Komisionit), Valentin Doci (Anetar i Komisionit), Valentina Lleshaj (Anetare e Komisionit). Gjithashtu i pranishëm ishte, Pergjegjesi i Finances Z.Dritan Lika, i cili dha shpjegime për projektin e mësipërm.

Pergjegjesi i finances Z.Dritan Lika shpjegoi se , Tavanet Pergatitore të Shpenzimeve, të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029, janë hartuar duke u bazuar në objektivat e zhvillimit të Bashkisë, të cilat lidhen me funksionet respektive të vetëqeverisjes vendore, të percaktuara në kuadrin ligjor. në nivel programi, ku çdo program lidhet me një funksion të veçantë të pushtetit vendor, brenda të cilit janë përfshirë një ose më shumë njësi.

Dokumenti i PBA-se, prezanton qëllimet, objektivat dhe produktet për çdo program, duke u fokusuar në programet me prioritet, të cilat janë shprehje e kërkesave dhe nevojave të komunitetit.

Ky projekt Afatmesëm bazohet në vizionin tonë për Fushe-Arrezin, i cili para se gjithash duhet të jetë një qytet lehtësisht i jetueshem, me infrastrukture moderne, me shërbime efikase dhe cilësore, me mundësi investimi për sipërmarrësit, me një jete kulturore e sportive të larmishme, me hapësira të gjelbërta të dedikuara për femijet dhe të moshuarit.

Ai thotë se, në jemi të bindur se pavarësisht problemeve të shumta, qyteti i Fushe Arrezit, mbart një potencial të konsiderueshëm ekonomik, social e kulturor.

Pergjegjesi i Finances Z.Dritan Lika thekson se:

Objektivi themelor i këtij Programi Afatmesëm është përmirësimi në vazhdim i cilësive të jetesës në Bashkinë e Fushe Arrezit, nëpërmjet mbrojtjes së mjedisit, rritjes së sigurisë në rrugë e në objektet shkollorë, përmirësimi të kushteve në çerdhe, kopshte e shkolla, ofrimit të shërbimeve

sociale cilësore, rritjes së punësimit dhe zhvillimit të ekonomisë rurale, turizmit, etj.

Z. Lika shpjegon gjithashtu se parashikimi i te ardhurave e shpenzimeve është bazuar ne:

1. Paketën fiskale të Bashkisë së Fushë Arrez.
2. Shpërndarjen e burimeve në përputhje me prioritetet e zhvillimit të qytetit.
3. Prioritetet e qytetarëve të evidentuara gjatë takimeve në çdo nivesi administrative.

Shtyllat kryesore në të cilat është mbështetur hartimi i tavanëve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029, janë :

- Zhvillimi ekonomik i qytetit dhe nxitja e punësimit;
- Garantimi i pastërtisë së qytetit dhe i cilësisë së ajrit;
- Ofrimin e shërbimeve cilësore;
- Përmirësimin e infrastrukturës arsimore;
- Përmirësimin e infrastrukturës rrugore;
- Nxitjen dhe mbështetjen e aktiviteteve sportive, të cilat ndikojnë në shëndetin e popullatës;
- Gjallërimi i jetës kulturore dhe artistike, nëpërmjet mbështetjes së projekteve;
- Mbështetja e turizmit.

Në çdo program janë parashikuar të gjitha shpenzimet, duke përfshirë funksionet e veta dhe funksionet specifike, sipas llojit dhe njësive shpenzuese, ku përfshihen : Shpenzimet, Programet ekonomike, Tavanet e Shpenzimeve.

Përmes Tabelave në Monitor jepen detajet lidhur me:

Totalin e shpenzimeve për çdo Program;

Planifikimin, Menaxhimin dhe Administrimin;

Sigurinë publike;

Zhvillimin Ekonomik dhe Rural;

Arsimin, Kulturën, Sportin, Çështjet Sociale;

Punët Publike;

Fondin Rezerve dhe Kontigjencë.

Programi Buxhetor Afatmesëm është instrumenti më i rëndësishëm i menaxhimit financiar, i cili synon integrimin e programit të Bashkisë së Fushë Arrez me nevojat e qytetarëve dhe që do të shërbejë si bazë për planifikimin e shpenzimeve korente dhe kapitale për periudhën 2027-2029, duke prezantuar politikat financiare afatmesme të Bashkisë.

Pasi përfundoi diskutimi anëtarët e komisionit rane dakord me shumicë votash duke e dërguar projektvendimin për shqyrtim të metejshëm dhe miratim në mbledhjen Plenare të datës 30.03.2026.

Duke kërkuar bashkëpunimin tuaj!

**PER KOMISIONIN**

Valentina Lleshaj  
Zef Cerçe  
Beniana Maraku

Franc Doda  
Valentin Dogi